



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 30.07.2013
Nr. 0204 - 987

PËR: Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes
Kujtim Xhelili, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË SHTIMES, Npi. 01/163, Pranuar me datë, 24.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Npi. 01/163, të miratuar me datë 01.07.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Npi. 01/163 për refuzimin e ankesës, 01 Nr. 016/4339 të Iلمي Sadriut nga fshati Davidovc.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 30.07.2013
br. 0204 - 987

Za: Naim Ismajli, Gradonačelnik opštine Štimlje
Kujtim Xhelili, Predsedavajući Skupštine opštine Štimlje

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Štimlje, Npi. 01/163, Primitjeno dana ,
24.07.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke Npi. 01/163, odobreno dana 01.07.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka Npi. 01/163 za odbijanje zahteva , 01 br. 016/4339 Ilmi Sadria iz sela Davidovc.

Sa poštovanjem.

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr.006/4728, Datë: 25.6.2013



Npi – 01/163, Datë: 1.7.2013

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi ankesën me numër: 01Nr.016/4339, datë:18.6.2013, të z.Ilmi Sadriu, administrator i fshatit Davidovc, i cili në emër të një pjese të komunitetit të fshatit Davidovc, ka paraqitur ankesë Kuvendit Komunal-Shtime, në Vendimin me numër, 01Nr.06/766-80, datë: 05.04.2013, për emërtimin, e rrugëve, dhe shesheve, në Komunën e Shtimes, siç ka deklaruar pala për shkak të:

- a) Cenimit qenësor të drejtës së deklarimit të lirë të qytetarëve për emërimin e rrugëve në Davidovc.
- b) Emërimi i gabuar i rrugëve jashtë vullnetit të Komunitetit përkatës.
- c) Shkeljes së gabuar të drejtës materiale në aspektin Ligjor për emërimin e rrugëve.
- d) Për mosrespektimin e nenit 7 pika 2 dhe nenit 8 pika 2 e Ligjit Nr.04/L-071 Për Sistemin e Adresave, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prandaj propozojmë që kuvendi Komunal –Shtime të shqyrtoj këtë vendim dhe të vendosë sipas emërimeve të propozuara nga pjesa e komunitetit të fshatit Davidovc.

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E ANKESËS, 01Nr.016/4339
TË ILMI SADRIUT NGA FSHATI DAVIDOVÇ

I

Kuvendi Komunal – Shtime në mbledhjen e gjashtë të rregullt për vitin 2013, të mbajtur më datën: 1.7.2013, me shumicën e votave ka vendosur që të refuzoi ankesën me numër: 01Nr.016/4339, të z.Ilmi Sadriu, nga fshati Davidovc, me arsyetimin se Kuvendi Komunal, ka vendosur për këtë çështje.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili